



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:264681
Datë: 03.02.2025
Numri i dokumentit: 06796167
C.nr.4070/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.B., V.K., S.K., Y.B. që të gjithë mësimdhënës në IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren, të cilët me autorizim i përfaqëson i av. V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensim mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 4,893.00 euro, jashtë seancës, me datë 03.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.B., V.K., S.K., Y.B. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, t'ia paguaj shumat si në vijim:

- Paditësit A.B. për periudhën kohore nga data 18.04.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 21 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,265.25 euro.
- Paditëses V.K. për periudhën kohore nga data 18.04.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 21 muaj (për çdo muaj shumën prej 78.10 euro, në shkallë prej 35% të pagës bazë 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,640.10 euro.
- Paditësit S.K. për periudhën kohore nga data 18.04.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 21 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,265.25 euro.

- Paditësit Y.B. për periudhën kohore nga data 18.04.2021 deri më datë 15.04.2022 apo për 12 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 723.00 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 4,893.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 22.11.2023, e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 300.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit A.B., V.K., S.K., Y.B. që të gjithë mësimdhënës në IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren, përmes të autorizuarit të tyre av. V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 22.11.2023, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensim mbi bazën e kualifikimit.

Në referatin e padisë, i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune në IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren si mësimdhënës me diplomë fakulteti e të cilët në bazë të vendimit nr. 01/33 të datës 29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mendimit Juridik 2014/2023 të datës 09.10.2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe Kontratës Kolektive, i është garantuar e drejta në realizimin e pagave shtesë mbi bazën e kualifikimit nuk iu janë paguar në tërësi shtesat mbi bazën e kualifikimit, çka e paditura ia ka paguar vetëm pjesërisht dhe jo në tërësi. Ka theksuar se paditësit A.B. dhe S.K. realizojnë pagën bazë prej 459 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 123.93 euro, për secilin muaj e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë vetëm shumën prej 63.68 euro, për secilin muaj, duke i mbetur borxh shumën prej 60.25 euro për secilin muaj edhe atë nga data 18.04.2021 deri me datë 06.02.2023 dhe gjithsej 21 muaj, që në rastin konkret shuma e pa paguar është $21 \times 60.25 = 1,265.25$ euro, paditësi Y.B. realizon pagën bazë prej 459 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 123.93 euro, për secilin muaj e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë vetëm shumën prej 63.68 euro, për secilin muaj, duke i mbetur borxh shumën prej 60.25 euro për secilin muaj edhe të nga

data 18.04.2021 deri me datë 15.04.2022 dhe gjithsej 12 muaj, që në rastin konkret shuma e pa paguar është $12 \times 60.25 = 723$ euro, paditësja V.K. realizon pagën bazë prej 459 euro, ndërsa shtesën prej 35% të kësaj page apo shuma prej 160.65 euro, për secilin muaj e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë vetëm shumën prej 82.55 euro, për secilin muaj, duke i mbetur borxh shumën prej 78.10 euro për secilin muaj edhe të nga data 18.04.2021 deri me datë 06.02.2023 dhe gjithsej 21 muaj, që në rastin konkret shuma e pa paguar është $21 \times 78.10 = 1,640.10$ euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë 624.00 euro, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 60.00 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi deri më 01.02.2023, janë ta pabazuara për arsye se në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund ka theksuar bazuar në nenin 35 të KKAK-së, e drejta për licencim apo kualifikim, nuk është e përfshirë si detyrim për kompensim, çka padinë e paditëses e bënë tërësisht të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura IAAP “Ymer Prizreni” në Prizren, si mësimdhënës. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të paguar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër të protokollit 37, e datës 01.11.1990, e lidhur ndërmjet paditësit A.B.dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës. Paditësi ka diplomuar me datë 01.04.1990 dhe ka marr titullin profesional Ekonomist i Diplomuar dhe ka licencë të karrierës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro, nga kontrata e punës me numër të protokollit 199, e datës 01.10.2009, e lidhur ndërmjet paditëses V.K. dhe të paditurës, rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse. Nga çertifikata me numër të referencës 4/2042, të datës 25.07.2016, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” vërtetohet se V.K. e regjistruar në vitin akademik 2011/2012, në studimet master në Fakultetin e Edukimit, programi mësimdhënia dhe kurrikula, ka mbrojtur me sukses tezën e masterit me titull zbatimi i metodës COOL në shkollat e mesme profesionale në Kosovë me datë 24.06.2016 dhe ka marr titullin profesional Master i Edukimit në Mësimdhënia dhe Kurrikula dhe ka licencë të karrierës, ndërsa diplomën e ka marr me datë 18.06.2021. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 82.55 euro, nga kontrata e punës me numër të protokollit 96, e datës 01.10.2006, e lidhur ndërmjet paditësit S.K. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës. Paditësi ka diplomuar me datë 21.03.1989 dhe ka marr titullin profesional Ekonomist i Diplomuar dhe ka licencë të karrierës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro, nga kontrata e punës me numër të protokollit 202, të datës 01.09.2010, e lidhur ndërmjet paditësit Y.B. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës. Paditësi ka diplomuar me datë 10.11.1892 dhe ka marr titullin profesional Profesor dhe ka licencë të karrierës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit

është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësi në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimmshënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimmshënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimmshënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë paditësve A.B., V.K., S.K., Y.B. ia ka paguar shumën prej 63.68 euro, ndërsa paditësës V.K. shumën 82.55 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit A.B., V.K., S.K., Y.B. përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 123.93 euro, ndërsa paditësja V.K. përfiton ngritje prej 35% të

pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë prej 160.65 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që secilit prej paditësve A.B., S.K. për çdo muaj t'ia paguaj shumë prej 60.25 euro apo diferencën e mbetur për 21 muaj, nga data 18.04.2021 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej 1,265.25 euro ($21 \times 60.25 = 1,265.25$) euro, paditësit Y.B. për çdo muaj t'ia paguaj shumë prej 60.25 euro apo diferencën e mbetur për 12 muaj, nga data 18.04.2021 e deri më datë 15.04.2022, në shumë të përgjithshme prej 723.00 euro ($12 \times 60.25 = 723.00$) euro, ndërsa paditëses V.K. për çdo muaj t'ia paguaj shumë prej 78.10 euro apo diferencën e mbetur për 21 muaj, nga data 18.04.2021 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej 1,640.10 euro ($21 \times 78.10 = 1,640.10$) euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumë përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë (22.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet e palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së, lidhur me Rregulloren për Tarifat e Odës së Avokatëve e datës 18 mars 2017, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguaj shumë e përgjithshme prej 300.00 euro dhe atë për përpilimin e padsisë shumë prej 260.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 40.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, pasi që sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës në kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10,000 euro, shuma për përpilimin e padsisë për katër paditës është 260.00 euro, e jo 624.00 euro sa ka kërkuar i autorizuari i paditësve në padi, po ashtu gjykata e ka aprovuar shumë prej 40.00 për taksën gjyqësore pasi që nga urdhërpagesa shihet se taksa është paguar në shumë prej 40.00 euro dhe jo në shumë prej 60.00 euro.

Numri i lëndës: 2023:264681

Datë: 03.02.2025

Numri i dokumentit: 06796167

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4070/2023, me datë 03.02.2025

Gj y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.